REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE PUBLIKE,ZHVILLIMIT RURAL DHE URBAN
DREJTORIA E SHERBIMEVE PUBLIKE

Nr.4658 Prot

Lushnje, më 18/05/2026

RELACION
KËSHILLIT BASHKIAK
PËR MIRATIMIN E DHËNIES SË NDIHMËS FINANCIARE Z.PETRO DAKA BANESA E TË CILIT ËSHTË DËMTUAR NGA ZJARRI. LAGJA "XHEVDET NEPRAVISHTA"/ NJ.A.NR.2.

Z.Petro Daka është banor i lagjes "Xhevdet Nepravishta", Njësia Administrative Nr.2, Bashkia Lushnje, ka paraqitur kërkesën me Nr. Prot.3516 datë.14/04/2026 për verifikimin e dëmeve të shkaktuara në banesën e tij nga rënia e zjarrit dhe ka kërkuar ndihmë për rehabilitimin e saj. Për verifikimin e kërkesës së qytetarit janë ngritur komisionet me urdhërat përkatës :

1. Urdhëri për ngritjen e komisionit të konstatimit të dëmeve të shkaktuara në banesë Nr.110 Prot. datë. 04/05/2026, i përbërë nga:
   a. Agon Hajdari — Kryetar
   b. Xhejdi Saraçi — Anëtar
   c. Artur Sinani — Anëtar

2. Urdhëri për ngritjen e komisionit të ekspertëve për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në banesë me Nr.111 Prot. datë. 04/05/2026 i përbërë nga:
   a. Elton Koroveshi — Kryetar
   b. Flavia Korreshi — Anëtare
   c. Xhoana Ikonomi — Anëtare

Komisjoni pasi bëri verifikimin e dëmeve të shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesën e Z.Petro Daka, referuar kërkesës së tij, është hartuar preventivi me zërat e orendive të dëmtuara. Në bazë të V.K.M. Nr:329, datë 16.05.2012, "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuar nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuar nga veprimtari njerëzore, të

dëmtuarit i jepet ndihmë financiare 50% e vlerës. Bazuar në preventivin e hartuar vlera e dëmit të shkaktuar në banesën e Z.Petro Daka është përllogaritur në vlerën 205 750 (dyqind e pesë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë. Në këto kushte propozojmë këshillit të bashkisë të miratojë një ndihmë financiare në vlerën 102 875 (njëqindë e dy mijë e tetëqindë e shtatëdhjetë e pesë) lekë.

Referuar dhe vërtetimit për rënie zjarri me Nr.04 Prot. datë 04/05/2026 lëshuar nga MZSH Lushnje që vërteton rënien e zjarrit në banesë.

Faleminderit për mirëkuptimin!

I AUTORIZUARI
DREJTORISË SË SHËRBIMEVE
ELTON KOROVESHI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
LUSHNJE

Nr.4658/1 Prot.

Lushnje,më 18/05/2026

PROJEKT – VENDIM

NR. 45 DATË 18/05/2026

PËR MIRATIMIN E DHËNIES SË NDIHMËS FINANCIARE Z.PETRO DAKA PËR REHABILITIMIN E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA RËNIA E ZJARRIT NË BANESË, LAGJA "XHEVDET NEPAVISHTA"/NJ.A.NR.2.

KËSHILLIT TË BASHKISË LUSHNJE

Në mbledhjen e datës ___/___/2026 pasi analizoi relacionin e paraqitur nga zyra e Emergjencave Civile dhe në bazë të Ligjit Nr.139/2015 datë 17/12/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 3, shkronja "e" , neni 40, pika 1, VKM Nr. 414 datë 08/07/2021, pika 3.1, shkronja "a", pika 5, pika 6, Ligjit Nr.45/2019 "Për Emergjencat Civile", Neni 7, Neni 30 germa " gj", VKM Nr. 329 datë 16/05/2012, Paragrafi III, gërma "e" , gërma "ë" dhe "f", "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore" sipas kërkesës së Z.Petro Daka me Nr.3516 Prot. datë.14/04/2026.

PROPOZOJ :

1-Të miratojë kërkesën e Bashkisë Lushnje për mbështetje financiare të shtetasit **Z.Petro Daka** për dëmtimin e banesës së tij.

2-T'i akordojë familjes së shtetasit Z.Petro Daka ndihmën financiare, emergjente në vlerën prej, **102 875 (njëqindë e dy mijë e tetëqindë e shtatëdhjetë e pesë) lekë** nga fondi i kushtëzuar i Emergjencave – Civile me kod 91707AB, i destinuar dhe miratuar nga Këshilli i Bashkisë për vitin 2026.

3-Ngarkohen me zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve dhe e Financës.

4- Vendimi hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

I AUTORIZUARI
DREJTORISË SË SHËRBIMEVE
ELTON KOROVESHI

DREJTORI JURIDIK
BEDRI HIDA

KRYETARE
ERISELDA SEFA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA LUSHNJE